



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KOLONJË
DREJTORIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

PROJEKT-VENDIM

Nr. ____, datë __. __. 2025

**PËR MIRATIMIN E DHËNIES SHOQËRISË ERSEKA SOLAR PARK 3 LOT 1 SH.P.K TË SË
DREJTËS SE KALIMIT TE KORRIDORIT TE LINJES ELEKTRIKE ME VENDNDODHJE
NË BASHKINË KOLONJË, QARKU KORÇË, NË PRONAT SHETETËRORE NË PRONËSI TË
BASHKISË KOLONJË.**

Në mbështetje të Ligjit nr.139/2015 datë, 17.12.2015 "*Për Vetëqeverisjen Vendore*", ndryshuar, Ligjit nr.107/2016 "*Për Prefektin e Qarkut*", Ligjit nr.115/2014 "*Për Ndarjen Administrativo-Territoriale të Njësive të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë*", Ligjit nr.8744 datë 22.02.2001 "*Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në Njësitë e Qeverisjes Vendore*" Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 247 datë, 27.03.2013 "*Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose përdorim të Komunës Qendër Ersekë të Qarkut të Korçës*", aktualisht me ndarjen e re Aaministrativo-territoriale me Ligjin nr. 115/2014 "*Për ndarjen Administrativo-Territoriale të Njësive të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë*" të ndryshuar, kanë kaluar në pronësi/përdorim të Bashkisë Kolonjë, kërkesës Nr. 15 Prot., Datë 18.08.2025 të shoqërisë Erseka Solar Park 3 Lot 1 sh.p.k, person juridik shqiptar me NIPT M5400/002H, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e datës, 06.10.2025,

PROPOZOI:

1.Të miratojë dhënien Shoqërisë Erseka Solar Park 3 Lot 1 sh.p.k për efekt të kalimit të korridorit të Linjës Elektrike për projektin impianti Fotovoltaik "*Erseka Solar Park 3, Lot 1*" me vendndodhje në Bashkia Kolonjë, Qarku Korçë të së drejtës së kalimit për korridor linje elektrike në pasuritë shtetërore të mëposhteme në pronësi të Bashkisë Kolonjë:

- Pasuria nr.132/33, ZK. 3510, Starje, Kolonjë, 0.009 km (shkëmbore)
- Pasuria nr.360, ZK. 3510, Starje, Kolonjë, 0.097 km (Ledh)
- Pasuria nr. 93/58, ZK. 3510, Starje, Kolonjë, 0.011 km (Ledh)

2.Lidhjen dhe nënshkrimin për këtë qëllim të Kontratës/Marrëveshjes përkatëse konform kuadrit ligjor në fuqi me shoqërinë Erseka Solar Park 3 Lot 1 sh.p.k..

3.Ky p/vendim hyn në fuqi në mbështetje të Ligjit nr.139/2015 datë, 17.12.2015 "*Për Vetëqeverisjen Vendore*", i ndryshuar.

KRYETARI
Erion Isai

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
NËNKRYETAR
Petro Risto



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KOLONJË
DREJTORIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Nr 5392 Prot

Ersekë, më 01.10.2025

RELACION
PËR
PROJEKT VENDIM

Nr. ____, datë __. __. 2025

**PËR MIRATIMIN E DHËNIES SHOQERISË ERSEKA SOLAR PARK 3 LOT 1 SH.P.K TË SË
DREJTËS SE KALIMIT TE KORRIDORIT TE LINJES ELEKTRIKE ME VENDNDODHJE
NË BASHKINË KOLONJË, QARKU KORÇË, NË PRONAT SHTETËRORE NË PRONËSI TË
BASHKISË KOLONJË.**

Të nderuar këshilltarë,

Pasuritë që do të përdoren dhe jepen ne përdorim:

- **Pasuria nr. 132/33 ZK 3510:** e llojit “shkëmbore” është e pashfrytëzueshme për bujqësi. Kjo kategori toke klasifikohet si “tokë e pafrytshme”, në përkufizim të Ligjit nr. 8752 datë, 26.03.2001 “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, i ndryshuar, si “**Tokë e pafrytshme**” kuptohet *toka cilësisht e dobët, që nuk përfshihet në zërat kadastralë: tokë bujqësore, tokë pyjore, pyje, kullota, livadhe e troje*”.

- **Pasuria nr. 360 ZK 3510** e llojit “Ledh” ndodhet në listën e miratuar me Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 247 datë, 27.03.2013 *“Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose përdorim të Komunës Qendër Ersekë të Qarkut të Korçës”* tokat jo bujqësore janë transferuar në pronësi të Komunës Qendër Ersekë.

- **Pasuria nr. 93/58 ZK 3164** e llojit “Ledh” ndodhet në listën e miratuar me Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 247 datë, 27.03.2013 *“Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose përdorim të Komunës Qendër Ersekë të Qarkut të Korçës”* tokat jo bujqësore janë transferuar në pronësi të Komunës Qendër Ersekë.

Referuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 247 datë, 27.03.2013 *“Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose përdorim të Komunës Qendër Ersekë të Qarkut të Korçës”*, janë **prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe ushqimit (Toka jo produktive) me nr. 333 rendor tokë jo bujqësore.**

Konceptoi: Specialist **O. Maili**


Miratoi: Drejtori D.B.ZH.R G. **Eminaj**

Konfirmoi: Drejtori D.Ç.J.P.P

O.Lifo

KRYETARI
Erion Isai

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
NËNKRYETAR
Petro Risto



364
3510

S

Plani vendisjes se
linjes elektrike ajrore
Starje - Rehove
Fragmenti ne pasuria
nr. 360 ZK 3510

361/3

Gjatesia 87 ml

360

Gjatesia 10 ml

Plani vendisjes se
linjes elektrike ajrore
Starje - Rehove
Fragmenti ne pasuria
nr. 132./33 ZK 3510

